

VENDIM
Nr. 504, datë 30.6.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË APLIKIMIT PËR PAJISJEN ME
AUTORIZIM IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANSITI TË ARMËVE TË ZJARRIT,
TË KOMPONENTËVE TË TYRE KRYESORË DHE TË MUNICIONEVE QË
LËSHOHEN NGA AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 13/2026, “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave të aplikimit për pajisjen me autorizim importi, eksporti dhe transiti të armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në këtë vendim derdhen në buxhetin e shtetit.
3. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tarifat për aplikim për pajisjen me autorizim importi, eksporti dhe transiti të armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve

SHËRBIMI	TARIFA NË LEKË
1. Autorizimi i vetëm për import/eksport	5 000
2. Autorizimi i vetëm për import të përkohshëm	3 000
3. Autorizimi i thjeshtuar për eksport (rieksport, eksport i përkohshëm)	3 000
4. Autorizimi i shumëfishtë për import/eksport	10 000
5. Autorizim për transit	3 000